



# FAKULTETI EKONOMIK

## SYLLABUS

<b>LËNDA:</b>	<b>MENAXHIMI I PRODHIMIT</b>	
<b>Niveli i kursit:</b>	BSc	
<b>Lloji i kursit:</b>	ZGJEDHORE	
<b>Viti i studimeve</b>	II – të	
<b>Semestri:</b>	IV	
<b>Kodi dhe shifra e lëndës:</b>		
<b>Koha/lokacioni:</b>		
<b>Ligjëratat:</b>		
<b>Ushtrimet:</b>		
<b>Mësimdhënësit e kursit:</b>	Mr. Sc. Vehbi Ramaj Phd. candidat	e-mail: <a href="mailto:yehbiramaj@yahoo.com">yehbiramaj@yahoo.com</a> <a href="mailto:yehbi_rama@universitetiaab.com">yehbi_rama@universitetiaab.com</a>

### 1. Përshkrimi i lëndës

Objektivi i këtij programi është të ofroj njohuri sa më të avancuara teorike dhe praktike nga fusha e Menaxhimit të prodhimit, të nevojshme për të menaxhuar bizneset, shërbimet publike dhe institucionet tjera të një spektri më të gjerë.

Me anë të kësaj lënde synohen të arrihen edhe këto qëllime themelore: Menaxhimi i prodhimit si proces dhe sistem, pastaj menaxhimi i cilësisë dhe kontrolli total i cilësisë. Projektimi i procesit dhe zgjedhja e teknologjisë. Menaxhimi dhe njohja me teknologjinë e procesit, teknologjinë e përpunimit të materialeve, teknologjinë e përpunimit të informacionit si dhe përmasat e teknologjisë. Kapaciteti dhe sistemimi i makinave dhe pajisjeve për prodhim si dhe planifikimi dhe kontrolli i projektit. Menaxhimi i rezervave, planifikimi i kërkesave për materiale si dhe projektimi dhe matja e punës.

Lënda do të ligjërohet me anë të prezantimeve të detajizuara për secilën pikë, si dhe me ushtrime lidhur me menaxhimin e operacioneve dhe të prodhimit

<b>2. Qëllimet e lëndës</b>	Krijimi i aftësive ( dijeve dhe shkathtësive ) për të menaxhuar në mënyrë efektive me prodhimin, sipas metodologjive dhe standardeve ndërkombëtare.
<b>3. Rezultatet e pritura</b>	Programi ofron mundësi për studentët që të pajisen me njohuri mbi teorinë, metodat, teknikat, si dhe aftësitë praktike për një menaxhment sa më bashkëkohor dhe praktik në harmoni me programet e avansuara mësimore në rajon dhe në botë. Studentët do të fitojnë kredi të mjaftueshme(ECTS) nga kjo lëndë në mënyrë që të jenë në gjendje të inkorporohen nëpër Universitetet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë sipas Deklaratës së Bolonjës.
<b>4. Metodologjia</b>	Ky kurs organizohet nëpërmjet të ligjëratave, punës në grupe të studentëve, pjesëmarrjes aktive në diskutime, diskutim i rasteve studimore. Përveç materialeve nga ligjëratat të cilat përmbajnë konceptet themelore të menaxhimit të prodhimit, studentet do të lexojnë dhe artikuj nga revista elektronike, sipas kapitujve përkatës. Ata do të marrin detyra për diskutim gjatë orëve ose për punë individuale dhe grupe. Studentët duhet të ballafaqohen me problemet reale të menaxhimit të prodhimit.
<b>5. Literatura</b>	<p><b>Literatura primare:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Suzana Panariti: Menaxhimi i operacioneve, Shtëpia botuese “Adel Print”, Tiranë 2008.</li> <li>2. Suzana Panariti: Menaxhimi i projektit, Shtëpia botuese “Libri Universitar” Tiranë, 2004</li> <li>3. Schroeder, Roger(1993), Operations Management-Decision making in the Operational Function, McGraw-Hill International Editions, fourth edition.</li> </ol> <p><b>Literatura sekondare:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Venetike Nakuçi: Menaxhimi cilësisë, “Julvin2”, Tiranë, 2008</li> <li>2. Dr.sc. Qemal Y Buçinca: Menaxhimi i prodhimitarisë; UM “Ilirija”-Prishtinë-2008</li> <li>3. Dr.sc. Qemal Y. Buçinca, Menaxhimi i sistemeve organizative; UM “Ilirija”-Prishtinë-2006</li> <li>4. Zelko Panian; Informatika afariste për ekonomist; Zagreb, 2003.</li> <li>3. Goodpasture, J.C.. Quantitative methods in Project Management, Rosss, Publishing Inc, 2003.</li> </ol>

	<p><b>Web-faqe të cilat mund të jenë në interes për studentët.:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <a href="http://www.wikipedia.org">http/ www.wikipedia.org</a>. Operations management</li> <li>2. <a href="http://en.wikipedia.org/wiki/operations_management">http://en.wikipedia.org/wiki/ operations management</a></li> <li>3. <a href="http://www.project-management-center.com/pmchome.htm">http://www.project-management-center.com/pmchome.htm</a></li> <li>4. <a href="http://www.ietf.org">http://www.ietf.org</a></li> <li>5. International Journal of Operations &amp; Production Management</li> <li>6.</li> </ol>	
<b>7. Politikat akademike dhe rregulloret e mirësjelljes</b>	<p>Studentët duhet ti respektojnë të gjitha politikat akademike dhe të mirësjelljes të Universitetit AAB-Riinvest, ndër të cilat janë edhe përcjellja me rregull e ligjëratave, ardhja me kohë në mësim, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog në ligjërata.</p>	
<b>8. Metodatat e vlerësimit</b>	<b>Testi I dhe II intermediarë</b>	<b>40 %</b>
	<b>Punimi seminarik dhe prezantimi</b>	<b>10 %</b>
	<b>Provimi Final</b>	<b>40 %</b>
	<b>Pjesëmarrja aktive në ligjërata dhe ushtrime</b>	<b>10 %</b>